Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**24.10.2023**	**28.10.2023**	**2023/0790**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.10.2023, OE "Mobelland" Sh.p.k. - Suharekë, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0790, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Graniti" Sh.p.k. - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe montimi me inventar plotesues per shkolla" me numër të prokurimit: "208 Udheheqesi-23-1024-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 €.

Lidhur me këtë aktivitet është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, me numër 2023/0312 i i datës: 06.07.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë me nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mendojmë që Autoriteti kontraktues i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

- Neni 7 i LPP-së
- Neni 59 i LPP-së
- Neni 61 i LPP-së
- Neni 4 paragrafi 4.3 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022
- Neni 40 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie të tenderit i cili ka qenë "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" Ne si Operator Ekonomik i jemi përgjigjur ftesës së AK-s për tender dhe kemi dorëzuar ofertën tonë duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ana e tyre si dhe duke iu përmbajtur kritereve dhe kërkesave në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Nga njoftimi B58 për Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde, kemi kuptuar që AK ofertën tonë e ka cilësuar si të pa suksesshme dhe e ka shpallur fitues një Operator Ekonomik të pa përgjegjshëm për shkak të arsyeve dhe fakteve të cilat do ti paraqesim në vijim:

Të pa kënaqur me vlerësimin e Autoritetit Kontraktues, ne kemi paraqitur kërkes për rishqyrtim të cilën AK e ka cilësuar si të pa bazë. Andaj për shkak që pretendimet tona kan qenë të bazuara, duke pasur parasysh se Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë për bazë provat dhe faktet e ofruara nga ana jonë, ne jemi detyruar që të paraqesim ankesë në Organin Shqyrtues të Prokuirmit (OSHP) me ç'rast pas shqyrtimit të ankesës, Paneli Shqyrtues e ka aprovuar si të bazuar dhe lëndën e kanë kthyer në rivlerësim.

Por edhe përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga ana e OSHP-s, nga publikimi i njoftimit B58 vendimi për dhënie të kontratës të datës 25.09.2023, vërejtëm që ju Autoriteti Kontraktues ka vendosur që përsëri të shpërblen me kontratë një O.E. të pa përgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-së pasi që nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe transparente të gjithë O.E. për faktin që ka favorizuar një O.E. të pa përgjegjshëm duke e shpërblyer me kontratë edhe përkundër se nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Gjatë shqyrtimit të raportit të ekspertit shqyrtues pasi kemi paraqitur ankesën në OSHP dhe gjatë analizimit të dokumenteve të paraqitura nga O.E. i rekomanduar për kontratë si dhe pas analizimti të kërkesës nr. 1 tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, vërejtëm që diploma e inxhinierit Emin Demaku ishte dorëzuar kopje e pa noterizuar. Në kërkesën në fjalë qartë është kërkuar: 1. Menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Ingjinier i diplomuar i teknologjisë se drurit apo master ose Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës-apo master i Arkitekturës me pesë vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV.

2. Inxhinier i diplomuar i Makinerisë, apo master i Makinerisë- (një), me tri vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV.

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

Dëshmia 1-2. Për menaxherin e Projektit dhe stafin profesional, të paraqiten diplomat përkatëse të noterizuara. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e nostifikuar nga MASHTI. Kopjen e kontratave ose parakontratat mbi marrëdhënien e punës, listën e projekteve që ka menaxhuar dhe CV e tyre, letër referencë në lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësit pas diplomimit.

Paneli shqyrtues me rastin e shqyrtimit të ankesës në arësyetimin e vendimit OSHP:

2023/0312 i ka sqaruar Autoritetit Kontraktues që mbetet përgjegjësi e AK që në fazën e ri-vlerësimit ti evdidentoj të gjitha lëshimet e mundshme dhe vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave ta bëjë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore konkretisht nenet 1, 59, 60 dhe 61 të LPP, konform kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, ndërsa AK edhe përkundër sqarimeve ka vendosur që ta shpërblen me kontratë një O.E. të pa përgegjshëm.

Gjatë vlerësimit Autoriteti Kontraktues ka bërë edhe shkelje të nenit 61 pasi që nuk i ka zbatuar dispozitat e këtij neni për të cilësuar si jo normalisht të ulët tenderin e O.E. të rekomanduar i cili i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me këtë nen si dhe në nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022. Analiza tregon që O.E. ka dorëzuar tender jo normalisht të ulët pasi që është mbi 30% më i lirë se mesatarja e të gjithë tenderëve të dorëzuar për këtë procedurë të prokurimit, është 10% më e ulët se oferta e dytë e përgjegjshme si dhe është plotësuar edhe kushti që kanë marrë pjesë mbi 3 tender. Pra duke e shprehur në shifra na del rezultati si në vijim: Kanë marrë pjesë 7 operator ekonomik. Vera e përgjithshme e tenderëve është: 138,193.19 / 7=197,418.84 / 1.3=151,860.64 Pra edhe kushti i dytë është plotësuar që të llogaritet si tenderi jo normalisht i ulët. Kushti i tretë kërkon që të jetë më shumë se 10% më i ulët se O.E. i dytë i përgjegjshëm. 164,105.00/1.1=149,186.36. Pra sikur shihet O.E. i rekomanduar i ka plotësuar të tri kushtet për tu konsideruar si tenderues i cili ka dorëzuar tender jo normalisht të ulët, andaj AK ka bërë shkelje edhe të këtyre dispozitave pasi që ka shpërblyer me kontratë një O.E. i cili ka ofruar tender jo normalisht të ulët.

Edhe pse Operatori Ekonomik ka dhënë një sqarim të kërkuar nga Autoriteti Kontraktes, në përshkrimin e çmimit të tijë ka paraqitur disa çmime të cilat nuk mund të arësyetohen pasi që nuk e mbulojnë as furnizimin e lëndës së parë. Në vijim po i analizojmë disa pozicione për të marr shembull:

Pozicioni nr. 11. – Sa i përket përbërjes apo konstruksionit për finalizim të këtij pozicioni duhet të kemi të qartë se është i përbërë nga lavamani, iverica dhe HPL 18 mm. Lavamani i kërkuar sipas specifikacionit dhe kulitetit të kërkuar, ka një kosto minimale prej 55.00 €.

Iverica me trashësi minimale 1.8 cm ka ksoto në vlerë prej 47.00 €. Ndrësa HPL (High Presure Laminat) me trashësi 18 mm ka kosto në vlerë prej 120.00 €. Pra totali i lëndës së parë për ktë artikull kushton 222.00 €. Andaj nëse e krahasojmë çmimin e dhënë nga O.E. i rekomanduar në vlerë prej 130.00 € konstatojmë që jo vetëm që është jo normalisht i ulët, por është çmim i pa realizueshëm.

Pozicioni nr. 16.- Sa i përket përbërjes apo konstruksionit për finalizim të këtij pozicioni duhet të sqarojmë se është i përbërë nga iverica 1.21 m2, shtofi 1.30 m2 dhe 4 këmbët nga inoxi. Lënda e parë iverica ka një kosto prej 7.67 €. Shtofi ka një kosto prej 4.42 € dhe këmbët kanë një kosto prej 8.00 €. Pra totali i lëndës së parë për ktë artikull kushton 20.09 €. Andaj nëse e krahasojmë çmimin e dhënë nga O.E. i rekomanduar në vlerë prej 6.00 € edhe për këtë artikull konstatojmë që jo vetëm që është jo normalisht i ulët, por është çmim i pa realizueshëm.

Nga përvoja jonë në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta në një qështje të njejtë Organi Shqyrtues i Prokurimit me vendimin PSH. nr. 360/22 ka konstatuar që oferta jonë është

e pa përgjegjshme për shkak se pas analizës, shqyrtimit si dhe krahasimit të çmimeve në mes të ofertës dhe çmimeve në treg për këtë aktivitet të prokurimit, Paneli shqyrtues deklaron që ka hasur në çmime të jo-kuptimta të ofruara nga O.E. i shpërblyer me kontratë, nga të gjitha pozicionet, Paneli Shqyrtues në veçanti ka dalluar disa pozicione si 1.5; pastaj 2.1; 2.2 2.5; 2.21; etj në të cilat janë ofruar çmime shumë të ulëta në krahasim me çmimet e tregut, kështu që paneli konsideron se bie ndesh me qëllimin dhe dispozitat ligore për prokurim publik. Më tej thekson se këto çmime në shikim të parë duken si jo të besueshme nëse krahasohen me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës.

Andaj, duke u bazuar në faktet e gjetura si dhe sqarimet e dhëna, paneli shqyrtues ka vendosur që për këtë aktivitet të prokurimit, O.E. i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm.

Provë: vendimi nr. PSH. nr. 360/22

Andaj vlerësojmë që me rastin e njejtë AK ka vendosur në kundërshtim me praktikën e OSHP-s për të njejtin rast. Kështuqë presim që për rastin e njejtë OSHP të jetë konsistente duke shqyrtuar çmimet jon normalisht të ulëta të paraqitura nga O.E. i rekomanduar dhe t'ia cilësoj ofertën e tyre si të pa përgjegjshme.

Autoriteti Kontraktues, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-s, paragrafi 4, pasi që në këtë nen shprehimisht është paraparë që Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një tender të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit pasi që sa i përket kërkesës nr. 1 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 në FDT është kërkuar që Për menaxherin e Projektit dhe stafin profesional, të paraqiten diplomat përkatëse të noterizuara. Pra AK nuk e ka përfill kërkesën e vetë me rastin e vlerësimit të tenderit. Pra O.E. nuk e ka plotësuar kushtin në fjalë dhe si pasojë është i pa përgjegjshëm.

Në nenin 40 paragrafi 40.6 të Rregullorës së Prokuirmit shprehimisht është paraparë që: Citat "40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Duke u bazuar në nenin 106 të LPP-s, si dhe në rrethanat dhe faktet e cekura më lartë, kërkojmë nga OSHP që të urdhëroj Autoritetin Kontraktues, automatikisht ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në fjalë, të shqyrtoj faktet e paraqitura në ankesën tonë dhe pas vërtetimit të fakteve të cekura më lartë, kërkesën tonë ta aprovoj si të bazuar ta urdhëroj Autoritetin Kontraktues që ta kthej lëndën në rivlerësim dhe të na shpërblen neve me kontratën në fjalë si Operator Ekonomik i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimn më të ulët .

KRITERET PËR VLERËSIM

<u>Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional:</u>

1.Menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Ingjinier i diplomuar i teknologjisë se drurit apo master ose Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës apo master i Arkitekturës me pesë vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV.

2 Inxhinier i diplomuar i Makinerisë, apo master i Makinerisë- (një), me tri vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV.

Dëshmia dokumentare:

Dëshmia 1-2. Për menaxherin e Projektit dhe stafin profesional, të paraqiten diplomat përkatëse të noterizuara. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e nostifikuar nga MASHTI. Kopjen e kontratave ose parakontratat mbi marrëdhënien e punës, listën e projekteve që ka menaxhuar dhe CV e tyre, letër referencë në lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësit pas diplomimit.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Deklaratë e komisionit vlerësues:

Me datën: 12.10.2023, OE "Mobelland" Sh.p.k. - Suharekë, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0790, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Graniti" Sh.p.k. - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "*Furnizimi dhe montimi me inventar plotesues per shkolla*" me numër të prokurimit: "208 Udheheqesi-23-1024-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 €.

Lidhur me këtë aktivitet është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, me numër 2023/0312 i i datës: 06.07.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Komisioni vlerësues i përbëre prej tre anëtarëve ka analizuar ne hollësi të gjithë dokumentacionet ne oferta të dorëzuara duke ju përmbajtur kritereve të kërkuara në dosjen e tenderit Rekomandon te shpallet si fitues i tenderit, operatorin ekonomik: Graniti SH.P.K .. Rr. Ibrahim Rugova p.n. 23000. Shirokë:. Suharekë. në shumen 106.962.28 EURO.

Komisioni rekomandon te zbatohet edhe nenin 29.4 i Rregullores se Prokurimit Publik. duke kërkuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës., ti kërkohet një përqindje me te lartë të sigurimit te ekzekutimin te kontratës si garanci për përmbushjen e saj. Arsyeja rekomandim te zbatimit te nenin 29.l. rrjedhë pas dërgimit të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, duke u bazuar ne paragrafin 41.1. 41.2. 41.3 dhe 41.4 te nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik dhe nenit 61 të: LPP-se duke. OE lartcekur përmes një parashtrese të dërguar në platformën e-prokurimi, ka arsyetuar çmimet e ofertës duke theksuar se kane nënshkruar edhe deklaratën nen betim.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Nuk ka.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht ka interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë aktivitet është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, me numër 2023/0312 i i datës: 06.07.2023.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Mobelland" SH.P.K.**

Sqarim hyrës:

OE ankues me datë 01.10.2023 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 03.10.2023 AK ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

- OE ankues pretendon se AK me vendimin e datës 25.09.2023 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi që ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional lidhur me diplomën e menaxherit të projektit.

Rrethanat e çështjes – në vijim janë paraqitur faktet dhe rrethanat procedurale relevante me këtë pretendim ankimor.

- AK në dosjen e tenderit tek kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën: "*1.Menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Ingjinier i diplomuar i teknologjisë se drurit apo master ose Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës apo master i Arkitekturës me pesë vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV2. Inxhinier i diplomuar i Makinerisë, apo master i Makinerisë- (një), me tri vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV* ." Si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesë është kërkuar: "*Dëshmia 1-2. Për menaxherin e Projektit dhe stafin profesional, të paraqiten diplomat përkatëse të noterizuara. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e nostifikuar nga MASHTI. Kopjen e kontratave ose parakontratat mbi marrëdhënien e punës, listën e projekteve që ka menaxhuar dhe CV e tyre, letër referencë në lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësit pas diplomimit."*
- OE i rekomanduar në ofertë ka dorëzuar dokumentin- "Deklarate për menaxherin e projektit", në të cilin shënohet *"Per tenderin me titull Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues për shkolla, me nr te Prokurimit: 208 Udheheqesi-23-1024-1-1-1 Nr.i brendshëm: 208 23 002111, deklarojme se menaxher projekti do te jete z.Fitim Abdullahu i diplomuar si lnxhinier i perpunimit te drurit."*
- Gjithashtu është dorëzuar Diploma e lëshuar nga Universitetit Bujqësor i Tiranë, në të cilën shënohet se z.Fitim Abdullahu, filloi studimet në vitin 2003 dhe i përfundoi në vitin 2009 në Fakultetin e Shkencave Pyjore, në Inxhinieri për Përpunim Druri, në formë me kohë të plotë. Kopja e diplomës është e noterizuar me numër Lrp.1637/2020 me datë 02.09.2020. Poashtu është bashkangjitur vendimi i datës 13.07.2010, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e Republikës së Kosovës, përkatësisht i Komisionit Kombëtar për njohjen e diplomave ku shënohet se z.Fitim Abdullahu i njihet grada universitare Diplomë të Integruar të nivelit të dytë në Inxhinieri për Përpunim Druri, fituar në Universitetin Bujqësor të Tiranës.
- Ndërkaq në lidhje me kërkesën 2 të kapacitetit teknik dhe profesional, është dorëzuar është dorëzuar Diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës, Fakulteti i Makinerisë, në të cilën shënohet se z.Avdi Fangu ka përfunduar studimet dhe merr titullin Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë. Së bashku me diplomë është dorëzuar edhe vërtetimi i kopjes së noterizuar me numër Nr.Lrp 3498/2023.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

- Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se OE ankues gabimisht i referohet stafit E.D si menaxher i projektit pasi që sipas deklaratës së OE të rekomanduar në cilësinë e menaxherit të projektit në këtë aktivitet është deklaruar z.Fitim Abdullahu. Ndërsa në lidhje me plotësimin e kërkesës për diplomë për menaxherin e projektit, konform sqarimeve të mësipërme është evidente se OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmitë konform kërkesës së AK-së për menaxherin e projektit. Poashtu nuk qëndron pretendimi as për kërkesën 2 (Inxhinierin e makinerisë) pasi që është dorëzuar diploma së bashku me kopjen e noterizuar për inxhinierin e makinerisë z. Avdi Fangu. Prandaj, sipas sqarimeve të mësipërme, OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmi dokumentare në lidhje me kualifikimin shkollor konform kërkesave të dosjes së tenderit, në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, dhe për rrjedhojë pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2

- OE ankues pretendon se AK me vendimin e datës 25.09.2023 ka vepruar në kundërshtim të nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik (më tej RrPP) pasi që OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta.

Rrethanat e çështjes – në vijim janë paraqitur faktet dhe rrethanat procedurale relevante me këtë pretendim ankimor.

- Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave dhe raportit të vlerësimit, në këtë aktivitet kanë dorëzuar ofertë OE në vijim:

1. OE "Mobelland" SH.P.K., me çmim të ofertës prej 164,105.00 euro.
2. OE N.T.SH. Delfina; PRIME CORPORATION L.L.C.; Erzeni shpk: me çmim të ofertës prej 214,400.00 euro.
3. OE NTP Blendi O.P.: me çmim të ofertës prej 197,733.00 euro.
4. GOE WOOD CORPORATION L.L.C.; SEDEF AHSAP: me çmim të ofertës prej 196,094.76 euro
5. OE "art & design" SH.P.K.: me çmim të ofertës prej 326,213.00 euro.
6. OE "GRANITI SH.P.K".: me çmim të ofertës prej 106,962.28 euro.
7. GOE "IBM SH.P.K".; Majlinda Bajraktari B.I.: me çmim të ofertës prej 176,424.00 euro.

- Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të publikuar nga me datë 12.05.2023, OE Graniti Sh.p.k është rekomanduar për shpërblim me kontratë.
- Me datë 17.05.2023, OE "Mobelland" Sh.p.k. (tute OE ankues), si palë e pakënaqur me vendimin e AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 18.05.2023. OE ankues me datë 29.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 312/23, kundër vendimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.
- Paneli Shqyrtues i OSHP përmes vendimit numër: 312/23 të datës 06.07.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka obliguar AK të bëjë rivlerësimin e ofertave.
- AK me datë 02.08.2023, ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, duke kërkuar shpjegime lidhur me çmimin jonormalisht të ulët.
- OE ankues me datë 03.08.2023 ka ngarkuar sqarimin ku ka përshkruar zbërthimin e çmimit të ofertës për 19 pozicionet.
- Me date 25.09.2023 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku ka rekomanduar për shpërblim me kontratë OE Graniti Sh.p.k.
- Përsëri, OE ankues si palë e pakënaqur me vendimin e AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 01.10.2023, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 03.10.2023. Në arsyetimin e refuzimit të këtij pretendimi, AK ka precizuar: "*[..] OE GRANITI SH.P.K, përmes platformës e-prokurimi, ka dërguar një sqarim të detajuar për secilin pozicion të paramasës duke e sqaruar secilin çmim të ofertës dhe atë duke elaboruar Çmimin e lëndës së parë, Shpenzimet e ndryshme në fabrikë, Punëtorët e prodhimit në fabrikë, Tatimin, Transportin (duke llogaritur dërgesën komplet) dhe fitimin. Në sqarimin e lartpërmendur, i njëjti ka treguar se me çmimin qe ka ofertuar është çmim i tregut dhe marzhën e interesit e kanë 20% (pra fitimin sipas kësaj oferte e kanë 20%) duke theksuar se e kanë nënshkruar edhe deklaratën nën betim AK-MASHTI, duke u bazuar në arsyetimin e OE GRANITI SH.P.K.- Shirokë, do te zbatoj nenin 29.4 E Rregullores së Prokurimit Publik, duke kërkuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, ti kërkohet një përqindje më e lartë e sigurimit të ekzekutimin të kontratës, si garanci për përmbushjen e saj Vlen të ceket se në këtë procedurë të prokurimin gjatë rivlerësimit të tenderit kemi pasur vetëm dy oferta të përgjegjshme, pasi qe ofertuesit tjerë nuk kanë bërë zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së tenderit të sigurimit te*

tenderit."

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

- Eksperti sqaron se në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta të konstatuara sipas kritereve të nenit 41.3 të RrPP, AK ka zbatuar procedurën *inter partes* me OE të rekomanduar. Në lidhje me vendimin e AK-së pas pranimit të sqarimeve (zbërthimit të çmimeve) neni 41.10 i RrPP përcakton që AK pas pranimit të sqarimeve nga OE në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta nëse sqarimi është i mjaftueshëm, e trajton tenderin njëjtë me tenderët tjerë, ndërsa nëse sqarimi nuk mjafton, e refuzon tenderin. Në këtë kuptim është në diskrecionin e AK-së të vendosë duke u bazuar në sqarimet e pranuara dhe në këtë rast AK është bindur që sipas sqarimeve në lidhje me çmimet, të trajtojë ofertën e OE të rekomanduar si ofertë me çmime të besueshme. Për me tepër Eksperti sqaron se OE ankues përveç pohimeve nuk ka dorëzuar asnjë provë mbështetëse që mund të argumentojë pretendimin ankimor se çmimet e ofertës së OE të rekomanduar nuk janë të besueshme. Prandaj, AK ka vepruar në përputhje me nenin 1 dhe 6 të LPP-së dhe nenin 41 të RrPP, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E ARSIMIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"Mobelland" SH.P.K.**

Kreshnik Spahiu